



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. 8/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Shukri Sylejmani, anëtar, në çështjen disiplinore ndaj N. M., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gj. duke vendosur sipas ankesës së tij, parashtruar kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), me numër KGJK. Nr. 160/2022 të datës 28 prill 2022, (nr. Prot. 01/650 dt. 13.05.2022), në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21 qershor 2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga N. M., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gj., kundër Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 160/2022 të datës 28 prill 2022.

A r s y e t i m i

Me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK Nr. 160/2022, datë 28 prill 2022, hedhet poshtë raporti me numër nr. AD/KGJK/01/2020/GJS-2021-015, i datës 29 mars 2022 dhe pushon procedura disiplinore ndaj A. Sh., N. M. gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gj. dhe R. A. ish Kryetar i Gjykatës Themelore në Gj., për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore të pretenduar nga Autoriteti Kompetent.

Kundër këtij Vendimi në afat ligjor gjyqtari N. M., në Gjykatë Supreme ka paraqitur ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; vendimit mbi hedhjen poshtë të raportit hetimor. Propozon që të anulohet vendimi i ankimuar , të refuzohet raporti hetimor me numër nr. AD/KGJK/01/2020/GJS-2021-015, i datës 29 mars 2022, për shkak se nuk është përgjegjës për veprën disiplinore.

Përgjigje në ankesë të palës ankuese N. M., në afat ligjor ka parashtruar KGJK, me propozim që Gjykata Supreme ta hudhë poshtë ankesën në mungesë të interesit juridik.

Gjykata Supreme e Kosovës pas vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar në vështirime të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës,

në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paneli Hetimor i themeluar me vendimin e KGJK nr. 18/22 të dt. 21 01.2022 me datë 29 mars 2022 ka paraqitur raportin lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduara të gjyqtarëve të lartë cekur, shkelje këto të rregullave të etikës përcaktuara nga neni 5 par. 2 ,nën par. 2.1 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas autoritetit kompetent gjyqtarët, në trup gjykues A. Sh., N. M. dhe R. A. kanë kryer detyrën zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, duke vepruar me përfundim paragjykues, seksist dhe ofendues në bazë të gjinisë, si në arsyetim të Aktgjykimit PKR nr. 200/2014 të dt. 24 mars dhe 27 korrik 2017.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në këtë çështje disiplinore ka mbajtur seancën dëgjimore, më 28 prill 2022, ku janë dëgjuar palët në procedurë, janë administruar provat, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe pretendimeve të subjektit hetimor, vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij, KGJK nr. 160/2022 të datës 28 prill 2022. Në arsyetim ndër të tjera arsyeton se, në rastin konkret është arrit parashkrimi absolut i shkeljeve disiplinore të pretenduara për të tre subjektet e këtij hetimi disiplinor. Nga koha e nxjerrje së Aktgjykimit përkatës PKR nr. 200/2014 të dt. 24.03.2017 dhe 28 07. 2017, kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore, e deri në fillimin e hetimit disiplinor ndaj këtyre subjekteve kanë kaluar më tepër se 2 (dy vite), ndërsa sipas Ligjit nr.05/L-003, për Plotësimet dhe Ndryshimet e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili ishte në fuqi në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore me nenin 15 par. 1 (50), ishte paraparë se procedura disiplinore nuk mund të filloj dhe zhvillohet në komisionin disiplinor pasi të kaloj afati prej 1 (një) viti , nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkeljen e supozuar dhe 2 (dy) vite nga shkelja e supozuar.

Pra në rastin konkret KGJK arsyeton se parashkrimi i shkeljes së supozuar disiplinore për gjyqtarët e lartë cekur A.Sh., N. M. dhe ish K. të Gjykatës R. A. , ka arritur me datë 28 korrik 2019, ndërsa procedura ka filluar me 10 janar 2022.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i drejt dhe i ligjor, vendimi i kontestuar është nxjerrë me zbatim të drejtë të drejtës materiale pasi që është vërtetuar se në rastin konkret është arrit parashkrimi absolut për shqyrtimin e shkeljeve apo përgjegjësisë disiplinore të subjekteve të lartë cekur sipas bazave ligjore dhe afateve të theksuara si më lartë, e që kjo çështje nuk është kontestuese nga asnjëra palë në procedurë pra as nga pala ankuese e cili e konfirmon në ankesë, si të qëndrueshëm se është arrit parashkrimi absolut i veprës së pretenduar disiplinore e cila i vihet në barrë.

Pretendimet e ankuesit si më lartë dhe theksimet e tjera se: nuk është përgjegjës në këtë rast sepse kompetent për hartimin e aktgjykimit është gjyqtari individual apo kryetari i trupit gjykues e jo anëtari i trupit gjykues siç ka qenë, se nuk mund të shpallet askush përgjegjës për një vepër e cila nuk parashihet me ligj në kohën e kryerjes, se mbetet hapësirë se mund të ketë qenë përgjegjës por për shkak të parashikimit të ndjekjes disiplinore është hedhur poshtë raporti, andaj kërkon të vendoset meritorisht çështja etj., Gjykata Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore por i refuzon si jo të bazuara në ligj, andaj janë irelevante dhe jo me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje me që kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes apo përgjegjësisë së supozuar disiplinore si në rastin konkret, ndërsa me ligj nuk parashihet që pas parashkrimit absolut të arritur të një veprë apo në rastin konkret të përgjegjësisë disiplinore, të shqyrtohet dhe të vendoset në merita të çështja e ngritur. Në rastet kur konstatohet arritja e parashkrimit ndërpritet çdo veprim i tejmë faktik dhe juridik i çështjes së ngritur. Prandaj me të drejtë KGJK e ka hedhë raportin hetimor të autoritetit kompetent dhe është pushuar procedura disiplinore ndaj palës ankuese për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes së pretenduar disiplinore.

Nga theksimet si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 15.6, të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME -PRISHTINË

AA. nr. 8/2022, me datë 21 qershor 2022

Kryetari i kolegjit,

Ragip Namani